

# Shoqërueset dhe ligji

Versioni 1.0. 21/04/10.



*Vini re që informacioni i mëposhtëm nuk synon të japë këshilla nga Escort-Ireland.com (E-I) dhe E-I s'është në asnjë mënyrë përgjegjës për përmbajtjen a përdorimin e këtij informacioni.*

Seksionet e mëposhtme japin një përmbledhje të ligjit brenda Republikës së Irlandës sa i përket njerëzve të përfshirë në tregtinë e seksit; domethënë shoqërueset femra, meshkuj, transseksuale dhe transvestitë që japin shërbime seksuale në këmbim të parave. Ky dokument paraqet një përmbledhje të asaj që është e ligjshme dhe e paligjshme në Republikën e Irlandës sa i përket punonjësve të seksist dhe përvijon të drejtat ligjore në rast se do t'ju bezdisin, kërcënojnë apo arrestojnë. Ai ndahet në disa seksione, që mbulojnë:

- Shoqërueset dhe mosha
- Puna në rrugë
- Shoqërimi më vete
- Ndërtesat / Vendndodhja e biznesit  
Ndërtesat që kontrollohen
- Puna për agjencitë e shoqërimit apo të tjerët
- Reklamimi
- Arrestimi
- Sugjerime

## Shoqërueset dhe mosha

**Situata ligjore:** Mosha ligjore në Irlandë për të bërë seks me vullnet është 17 vjeç. Nëse je nën 17 vjeç dhe arrestohesh për ofrim seksi për para, krijon një situatë të vështirë për veten, klientët dhe, nëse punon përmes një agjencie apo moteli, personin që drejton biznesin.

Është e ligjshme të japësh shërbime seksuale me pagesë nëse je 17 vjeç e sipër dhe është e ligjshme që një klient të marrë shërbime seksuale me pagesë nga një person me moshë 17 vjeç e sipër që nuk është me

probleme mendore. Ka kufizime se si dhe ku jepen këto shërbime në seksionet pasuese.

## Puna në rrugë

**Situata ligjore:** Është shkelje të nxjerrësh një person në rrugë apo vend publik me qëllim të prostitucionit. Kjo shkelje vlen për të gjithë, qofshin meshkuj a femra, prostituta a klientë, bile edhe për tutorin.

### Të drejtat tuaja:

**Urdhër për t'u larguar nga zona:** Një anëtar i Gardës që dyshon se një person po sillet në rrugë ose vend publik me qëllim të shitjes a blerjes së seksit, mund ta urdhërojë atë të largohet prej aty menjëherë. Nëse gardisti është në rroba civile ti ke të drejtë t'i kërkosh identifikimin por sapo të konfirmohet identifikimi duhet t'i bindesh urdhërit. Sjellja në rrugë përfshin pritjen në makinë ose në çdo lloj automjeti.

**Emri dhe adresa:** Nëse gardisti dyshon se ka ndodhë shitja apo sjellja në rrugë, ai mund ta arrestojë personin ose të kërkojë që personi të japë emrin dhe adresën e saktë. Nëse gardisti dyshon se emri dhe/ose adresa janë të rreme, ai mund ta arrestojë personin. Nëse personi s'pranon të japë emrin dhe adresën ose të japë emër dhe/ose adresë të rreme, mund të arrestohet dhe të gjobitet.

**Kontrolli:** Nëse gardisti dyshon se ke kryer shkelje, ai e ka të drejtën e kontrolli me ose pa pëlqimin tënd dhe përpara se të të ketë arrestuar. Gardisti duhet të të informojë se pse po kontrollohesh dhe sipas cilit ligj. Ke të drejtë të kontrollohesh në mënyrë të drejtë e me respekt pa u trajtuar në mënyrë degraduese. Nëse kontrolli është më shumë se thjesht kërkim nëpër xhepa, për shembull, ai duhet të zhvillohet nga një gardist i të njëjtit seks.

**Stacioni i Gardës:** Gardisti mund të të "kërkojë" të shkosh në një stacion të Gardës.

Në këtë rast mund të kundërshtosh. Nëse arrestohesh, je e detyruar të shkosh me gardistin në stacion.

**Arrestuar:** Gardisti duhet të të informojë për arsyen e arrestimit dhe sipas cilit ligj dyshohet se është kryer një shkelje. Nëse arrestohesh për shkeljen e shitjes apo daljes në rrugë, shih seksionin mbi arrestimin.

## Shoqërimi më vete

**Situata ligjore:** Në Irlandë është **e ligjshme** të punosh **më vete** si shoqëruese. Është gjithashtu e ligjshme të punosh tek dikush që jep shërbime të tjera jo-seksuale si përgjigjja në telefon, pastrimi ose siguria.

**Të drejtat tuaja:** Nëse punon më vete ose me dikë tjetër që nuk ka lidhje me shitjen e seksit, nuk kryhet asnjë shkelje. Duhet t'ia shpjegosh këtë situatë gardistit sa më mirë të mundesh. Nëse dy ose më shumë shoqëruese zbulohen duke punuar bashkë në të njëjtën ndërtesë dhe arrestohen, ka shumë mundësi që do të paditeni për hapje moteli. Në rastin kur një gardist thërret në ndërtesë ti ke të drejta të veçanta sa i përket kontrollimit të ndërtesës dhe lejimit të aksesit ndaj gardistit.

Nëse arrestohesh, shih seksionin mbi arrestimin.

## Ndërtesat / Vendndodhja e biznesit

Bazuar në seksionin e mëparshëm, është **e ligjshme** në Irlandë të punosh **më vete** si shoqëruese. Këto shërbime mund të jepen në çdo vend të mbyllur, p.sh. dhomë hoteli, apartament, shtëpi, pavarësisht se ndërtesa zotërohet apo është me qira nga shoqëruesja apo klienti. Kryesorja këtu është që shoqëruesja vepron më vete, kështu që shërbimi i shoqërimit është i ligjshëm. Edhe ofertat më të larta nga një shoqëruese që vepron në këtë bazë janë të ligjshme.

**Nuk është e ligjshme** për **dy ose më shumë njerëz** të ofrojnë shërbime seksuale nga i njëjti apartament, shtëpi, dhomë hoteli etj. Në raste të tilla vendndodhja përcaktohet të jetë motel.

Nëse është një numër shoqëruesesh që veprojnë në të njëjtën ndërtesë, për shembull nga një bllok apartamentesh, ndërtesat

mund të konsiderohen motel nëse mund të provohet se çelësat për apartamentet janë të përbashkët ose ka disa aspekte të përbashkëta mes shoqëruesve, p.sh. dushi ose banjot.

Është e njëjta gjë nëse dy ose më shumë shoqëruese veprojnë nga një dhomë hoteli, pra konsiderohet motel dhe është e paligjshme në Irlandë.

Nëse veprohet nga dhoma të ndryshme, qofshin apartamente apo dhoma hoteli, për sa kohë që nuk ka shërbime, telefona, laptopë etj. të përbashkët, shoqërimi do të konsiderohet më vete.

Në rastin kur telefonatave u përgjigjet një numër shoqëruesesh, kjo mund të konsiderohet të jetë pjesë e veprimit të një agjencie shoqërimi, që është e paligjshme në Irlandë.

Në rastin kur dy ose më shumë shoqëruese japin shërbime në një shtëpi, hotel, apartament etj., vendndodhja konsiderohet motel, prandaj kjo është e paligjshme.

Nëse arrestohesh shih seksionin mbi arrestimin.

## Kontrollimi i ndërtesave

Pavarësisht se a është klasifikuar vendndodhja si motel apo jo, të njëjtat të drejta zbatohen mbi shoqërueset që punojnë më vete ose në vende ku veprojnë dy ose më shumë shoqëruese.

### Të drejtat tuaja:

**Mandati:** Përgjithësisht gardisti s'mund të hyjë në shtëpinë apo vendin tuaj pa pajtimin tuaj. Nevojitet një mandat kontrolli në shumicën e rrethanave përveç kur gardisti ka mandat arrestimi për dikë që banon në ndërtesë ose nëse po ndjek një të dyshuar. Nëse gardisti të kërkon të hyjë në ndërtesë së pari duhet të konfirmosh identitetin e tij dhe stacionin ku punon. Gardisti do të ta japë këtë informacion që ti ta verifikosh dhe mandej ta lejosh. Duhet të pyesësh për natyrën e vizitës dhe nëse ka mandat. Nëse s'mund të flasësh anglisht apo të lexosh detajet e mandatit, duhet të përpiqesh ta shpjegosh këtë sa më mirë të mundesh. Nëse gardisti nuk ka mandat, nuk je i detyruar ta lejosh të hyjë.

**Kontrollimi i dhomave të hotelit:** Një gardist ka të drejtë të kontrollojë një dhomë hoteli nëse besohet se është kryer një shkelje ose pritet që një e tillë të ndodhë.

**Laptopat / celularët:** Gardisti mund të konfiskojë çdo gjë që konsiderohet se mund të përdoret si dëshmi për të ndihmuar prokurorinë, kjo përfshin prezervativët, lubrifikantët, celularët, laptopat, paratë etj. Mund të kërkohet fjalkalimi i kompjuterave, laptopëve, dhe numrat PIN të celularëve, ose mund të kërkohet që të tregohet informacioni i përmbajtur në çfarëdo paisje elektronike.

**Pasaportat ose kartat ID:** Nëse je shtetase e huaj, gardisti mund të të kërkojë të japësh pasaportën, kartën ID, kartën VISA ose çertifikatën e regjistrimit. Nëse nuk mund të japësh asnjë nga këto dokumente, mund të ndalohesh.

## Puna për agjenci shoqërimi apo të tjerë

Në Irlandë është e paligjshme të kontrollosh apo të drejtosh veprimtaritë e prostitucionit, dhe si të tilla, agjencitë e shoqërimit janë të paligjshme.

Një shoqëruese që punon për një agjenci, duke pranuar prenotime përmes agjencisë për shembull, por që punon më vete, sipas seksionit "Shoqërimi më vete", është e ligjshme. Ia vlen të theksohet kjo pikë përsëri që një shoqëruese që vepron vetëm mund të japë shërbime seksuale ligjërisht në shkëmbim të pagesës.

Nëse agjencia pranon pagesa në emër të shoqëruesve nga klientat, apo merr një përqindje nga shoqërueset për të dhënë prenotime, kjo konsiderohet si jetesë nga fitimi i prostitucionit prandaj është e paligjshme në Irlandë.

Një shoqëruese mund të punojë ligjërisht për dikë tjetër që ia organizon prenotimet etj., për sa kohë që ky person tjetër nuk angazhohet në dhënien e shërbimeve seksuale me pagesë. Është e paligjshme për personin tjetër të jetojë nga fitimet e bëra përmes shoqërimit.

## Reklamimi

Është shkelje në Irlandë që shoqërueset t'i reklamojnë shërbimet e shoqërimit që japin, është gjithashtu shkelje për njerëzit apo kompanitë të shtypin apo shpërndajnë me qëllim materiale të tilla.

Ia vlen të vihet re se reklamat e shoqërimit mund të përdoren si provë për të dëshmuar se është kryer shkelje si për shembull veprimi i një moteli.

## Arrestimi

Nëse arrestohesh për shkeljen e prostitucionit apo pse drejton një motel, që është padia më e mundshme, ke një numër të drejtash. Gardisti nuk ka nevojë për një mandat arresti në të gjitha rastet dhe qoftë edhe vetëm shkelja e një jo-nënshtatasi që nuk jep dokumentet identifikuese të nevojshme mund të pasojë në arrestimin tuaj. Ti nuk mund t'arrestohesh nëse një gardist beson që mund të ndihmosh në hetimin e një personi tjetër, p.sh. tutorit, nëmos ai person po hetohet për një krim më serioz kundër shtetit. Ka shumë mundësi që t'ju çojnë dhe t'ju mbajnë në një stacion të gardës.

### Të drejtat tuaja:

**Shënim:** Një gardist duhet t'ju thotë se jeni e arrestuar dhe arsyen e arrestimit. Mos rezistoni kur ju thuhet se jeni në arrest edhe nëse nuk është kryer ndonjë shkelje. Nëse ju thuhet se jeni arrestuar, edhe për pyetje, duhet të kërkosh menjëherë të flasësh me personin përgjegjës.

**Avokati:** Ke të drejtë të lidhesh me një avokat. Nëse nuk njehe ndonjë avokat duhet t'i kërkosh personit përgjegjës të caktojë apo të thërrasë një të tillë. Kjo e drejtë duhet t'ju thuhet kur arrini së pari në stacion. Nuk keni të drejtë të keni avokatin me vete kur pyeteni. Keni të drejtë të flisni me avokatin privatisht kur ai arrin në stacionin e gardës. Nëse ndodh diçka gjatë pyetjeve dhe ju mendoni se ju nevojitet ndihmë ligjore, duhet të kërkoni që intervista të ndalohet në mënyrë që të merrni këshilla nga avokati.

**Mik ose antar i familjes:** YKe të drejtë të lidhesh me një antar të familjes apo mik për t'i thënë që je ndaluar dhe vendin ku mbahesh.

Ke të drejtën e vizitës nga një antar i familjes, një mik ose person tjetër.

**Kontrollimi:** YMund të kontrolloheni por duhet t'ju thonë arsyen e kontrollit dhe ai duhet të bëhet në mënyrë respektuese. Nuk duhet të kontrolloheni nga një person i gjinisë tjetër (përveç doktorit).

**Sëmundja:** Nëse nuk ndjeheni mirë duhet ta informoni menjëherë personin përgjegjës ose gardën dhe të kërkonti vizitën e një mjeku. Nëse jeni me mjekime, duhet ta informoni personin përgjegjës menjëherë.

**Ushqimi, pija dhe gjumi:** Nëse keni uri ose etje duhet të kërkonti diçka për të ngrënë ose për të pirë. Keni të drejtë për të paktën 2 ushqime të lehta dhe 1 kryesor në ditë. Keni gjithashtu të drejtë për një kohë të arsyeshme për të fjetë. Ju lutem vini re se nëse vendosni të flini, periodha e ndalimit do të rritet me këtë sasi kohe, p.sh. nëse flini 6 orë do të mbaheni 6 orë më tepër.

**Sa mund të mbahem e ndaluar:** UZakonisht, periodha fillestare është 6 orë por kjo mund të zgjatet edhe për 12 - 18 orë të tjera nëse është e nevojshme dhe kjo varet edhe nga padia në fjalë. Mund të intervistohesh për një maksimum prej 4 orësh çdo herë.

**Intervista e gardës:** Vetëm dy gardistë mund të të intervistojnë në çdo kohë dhe nuk duhet të ketë më shumë se katër gardistë në dhomë në çdo kohë. Pyetja mund të ketë qasje të ndryshme. Ke të drejtën të MOS i përgjigjesh pyetjeve por kjo mund të merret më vonë si dëshmi kundër teje. Fol me një avokat para se të vendosësh a t'i përgjigjesh pyetjeve apo jo.

**Deklarata:** Dëshmia jote do të regjistrohet dhe do të të lexohet para teje në fund të

pyetjeve në mënyrë që të ndreqësh ndonjë gabim. Nëse pajtohesh me deklaratën ajo duhet nënshkruar, por VETËM pasi të jesh këshilluar me avokatin që të është caktuar. Nuk ke pse nënshkruan asgjë.

**Anglishtja:** Nëse nuk kupton apo flet anglisht mirë, ke të drejtën e një përkthyesi. Nën asnjë rrethanë nuk duhet të nënshkruash apo të përfshihesh në ndonjë bisedë kur je e arrestuar nëse nuk kupton se çka po flitet. Gjithmonë kërko të flasësh me avokatin e caktuar apo përkthyesin nëse ndonjë gjë është e paqartë.

**Gjykata:** YMund të paditesh dhe të çohesh në gjyq. Avokati dhe Këshilltari i Mbrojtjes Publike të përfaqësojnë këtu. Ke të drejtën të deklaroesh fajtores ose jo-fajtores. Nëse dënohesh, dënimi do të varet nga dënimet e mëparshme etj. Nuk do të futesh në asnjë Regjistër Shkeljesh Seksuale por do ta kesh të regjistruar këtë shkelje në Irlandë.

## Sugjerime

Përpiqu të punosh më vete por për arsye sigurie përpiqu të punosh me dikë që mund të përgjigjet në telefon, të pastrojë etj. Kjo është e ligjshme në Irlandë.

Nëse akuzoheni për ndonjë gjë, p.sh. mbajtje moteli, do të çohesh në gjyq si e pranove si s'e pranove akuzën. Nëse deklaroesh fajtores mund të dënohesh dhe do të ketë publicitet negativ. Nëse nuk e pranon akuzën, regjistroje mospranimin.

Gjithmonë kërko avokat dhe gjithmonë këshillohu me të para se të nënshkruash ndonjë gjë.

---

Mbi Escort-Ireland.com

Escort-Ireland.com (E-I) është faqja e internetit të shoqërimit më e njohur në Irlandë. Për informacione të mëtejshme shih <http://www.escort-ireland.com>.

---